



KOSOVË

**RAPORTI I PROGRESIT
DHE INDEKSI PËR
MROJTJEN E FËMIJËS
THEKSON MANGËSITË
KRYESORE NË SISTEMIN E
MBROJTJES SË FËMIJËS**

ChildPact është koalicion rajonal i 650 organizatave të shoqërisë civile të cilat avokojnë për reforma më të mira për mbrojtjen e fëmijëve në Evropën Juglindore dhe Kaukazin Jugor. I themeluar në 2011, ChildPact është koalicion i koalicioneve: anëtarët e tij janë rrjete kombëtare të organizatave të shoqërisë civile të cilat punojnë me fëmijë, nga 10 vende brenda zonave të Zgjerimit dhe Fqinjësisë së Bashkimit Europian.

www.childpact.org



Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë – KOMF është koalicion i përbërë nga 22 organizata vendore dhe ndërkombëtare që punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, me mision të përbashkët për të avokuar dhe mbrojtur të drejtat e fëmijëve në Kosovë. Misioni i Koalicionit të OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë është të promovojë mbrojtjen, respektimin, mirëqenien dhe avancimin e të drejtave të fëmijëve. Së bashku, ne do të avokojmë dhe llobojmë drejt institucioneve me influencë, për të promovuar dhe zhvilluar të drejtat e fëmijëve në përputhje me KDF.



Anëtarët e KOMF janë • Associazione Amici dei Bambini • Asociacioni për Trajnime Sociale, Hulumtime dhe Avokim – ASTRA • Action for Mothers and Children • Balkan Sunflowers Kosova • Iniciativa 6 • Kosovo Education for Sustainable Development • Kosovo Rehabilitation Center for Torture Victims KRCT • Organizata Rinore Akti • One To One Kosova – Qendra e Këshillimit Për Familje • One to One Children's Fund • OPFAKKOS • Programi për të Drejtat Civile • PL4Y International • Qendra për Edukim e Kosovës – KEC • Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit me qenie njerëzore – MVPT • Qendra për Studime të Avancuara FIT • Save the Children • SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë • Shpresa dhe Shtëpi për Fëmijët Kosovë • Terre des hommes • VoRAE dhe World Vision

www.komfkosova.org

Prill 2017

PËRMBLEDHJE

Kosova ka bërë një rrugë të gjatë drejt arritjes së parimeve të vendosura nga Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, por ende mbetet shumë për tu bërë. Raporti i Progresit të BE-së për Kosovën dhe rezultatet e Indeksit të Mbrojtjes së Fëmijës, ofrojnë një mundësi të jashtëzakonshme për të krahasuar dhe për të thelluar rekomandimet në lidhje me zhvillimin e mëtejshëm të mjedisit të mbrojtjes të fëmijës në Kosovë. Të dy dokumentet theksojnë çështje të ngjashme, si dhe përfshijnë rekomandime.

Raporti propozon një krahasim të tërthortë i cili përcjell përmbledhjen e Raportit të Progresit të BE-së për çështjet e fëmijëve duke u ndërlidhur me ato indikatorë të Indeksit, ku Kosova ka shënuar rezultat negativ (rezultati 0 – duke mos qenë aspak në përputhje me standardet e parashikuara).

Kosova duhet të bëjë një investim të fuqishëm financiar që të ndërtojë kapacitetin e duhur për të mbyllur hendekun mes legjislacionit dhe zbatimit të tij. Kosova duhet të ndërtojë një plan financiar të qëndrueshëm dhe të drejtë të shërbimeve sociale përmes krijimit të grantit specifik për shërbime sociale. Kosova duhet të krijojë monitorim të qëndrueshëm, të pavarur dhe mekanizma të inspektimit për të inspektuar cilësinë e ofrimit të shërbimeve. Hulumtimi dhe mbledhja e të dhënave duhet të jenë prioritet për të përcaktuar dominimin e çështjeve të ndryshme në Kosovë.

Kosova ende duhet të bëjë shumë përpjekje në luftimin e trafikimit të fëmijëve dhe punës së rëndë të fëmijëve, duke bërë një koordinim më efektiv mes autoriteteve të përfshira në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Kosova duhet të sigurojë kujdes më të mirë për fëmijët me aftësi të kufizuara si dhe duhet të mbledhë të dhëna dhe të monitorojë efektivitetin e masave për mbrojtjen e fëmijëve.

Veç kësaj, ky raport përmban informacion se si vendet e tjera të rajonit kanë prezantuar reformat kyçe në fushat ku politikat aktuale të Kosovës nuk janë në përputhje me KDF.



KOSOVË

PËRMBAJTJA

Ndërlidhja e Indeksit për Mbrojtjen e Fëmijës me Raportin e Progresit / faqe 3

Çfarë është Indeksi për Mbrojtjen e Fëmijës? / faqe 4

Krahasimi mbi shpenzimet buxhetore për mbrojtjen e fëmijëve / faqe 5

Krahasimi mbi fëmijët me aftësi të kufizuara / faqe 7

Krahasimi mbi koordinimin efektiv në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve / faqe 9

Krahasimi mbi drejtësinë për të mitur / faqe 11

Krahasimi mbi mjedisin e qeverisjes për mbrojtjen e fëmijëve dhe mbi mekanizmat e të dhënave, monitorimit dhe raportimit / faqe 12

Përfundime / faqe 14

“KOSOVA KA NDËRMARRË HAPA POZITIV PËR KRIJIMIN E POLITIKAVE NACIONALE DHE KUADRIT LIGJOR PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE. MEGJITHATË, SFIDË MBETET ZBATIMI I TIJ; KOSOVA DUHET TË ZBATOJË LEGJISLACIONIN DHE TË SIGUROJË BURIMET ADEKUATE PËR FUQIZIMIN E MBROJTJES SË FËMIJËVE. PËR MË TË PËR INSTITUCIONET NË NIVEL QËNDROR DHE LOKAL ENDE NUK JANË DUKE OFRUAR SHËRBIME TË MJAFTUESHME”

**Donjeta Kelmendi
Drejtoreshë Ekzekutive
Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë - KOMF**

NDËRLIDHJA E INDEKSIT PËR MBROJTJEN E FËMIJËS ME RAPORTIN E PROGRESIT

Kosova ka bërë një rrugë të gjatë drejt përmbushjes së parimeve të vendosura nga Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës. Megjithatë, autoritetet kanë përgjegjësi për të bërë edhe më shumë për mbrojtjen e fëmijëve më të cënueshëm. Raporti i Progresit të Bashkimit Evropian për Kosovën në 2016, thekson disa nga këto mangësi dhe përshkruan reformat kyçe që duhet të zbatohen.


Seksionet e Raportit të Progresit për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve duke u ndërlidhur me raportin e Indeksit të Mbrojtjes së Fëmijës, mundësojnë identifikimin e atyre sektorëve ku reformat nga autoritetet e Kosovës janë më të nevojshme, në mënyrë që të përputhen me angazhimet ndërkombëtare, si pjesë e procesit integruar me BE-në.

Edhe pse Kosova ende nuk e ka ratifikuar KDF-në, neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës thekson se marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare duke përfshirë KDF-në, janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë, dhe në rast konflikti, kanë përparësi ndaj dispozitave ligjore dhe akteve të tjera të institucioneve publike.

Rezultatet e Indeksit për Mbrojtjen e Fëmijës dhe informacioni nga Raporti i Progresit, ofrojnë një mundësi të jashtëzakonshme për të krahasuar dhe thelluar rekomandimet në lidhje me reformat që Kosova duhet të ndërmarrë për zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të mbrojtjes së fëmijës.

Edhe pse Indeksi në tërësi mat 626 indikatorë të mbrojtjes së fëmijëve, ky krahasim përcjell në mënyrë rigoroze përmbledhjen e Raportit të Progresit të BE-së për çështjet e fëmijëve duke u ndërlidhur me ato indikatorë të Indeksit ku Kosova ka shënuar rezultat negativ (rezultati 0 – duke mos qenë aspak në përputhje me standardet e parashikuara).

Gjithashtu, Indeksi për Mbrojtjen e Fëmijës tregon se si vendet e tjera në rajon kanë ndërmarrë masa më të mira për kriteret e paplotësuara të KDF-së nga Kosova, dhe tregon se çfarë mund të mësojë Kosova nga fqinjët e saj.



RAPORTI I PROGRESIT TË BASHKIMIT EVROPIAN PËR KOSOVËN NË 2016



ÇFARË ËSHTË INDEKSI PËR MBROJTJEN E FËMIJËS?

Indeksi për Mbrojtjen e Fëmijës është një instrument i krijuar bashkarisht nga World Vision dhe ChildPact, i cili mat sistemin e mbrojtjes së fëmijës të një shteti kundrejt një seti të përbashkët të indikatorëve. Indeksi është i bazuar në përshkrimet e disa neneve të KDF-së, si dhe në parimet e qasjes së sistemeve ndaj mbrojtjes së fëmijës. Rezultatet nga çdo vend ilustrojnë veprimet e qeverisë në drejtim të mbrojtjes së fëmijëve, përmes politikave, ofrimit të shërbimeve, kapaciteteve, llogaridhënies dhe koordinimit. Në këtë mënyrë, Indeksi nuk mat direkt mirëqenien e fëmijëve, por fokusohet në politikat qeverisëse, investimet dhe shërbimet.

Indeksi për Mbrojtjen e Fëmijës është pilotuar në 9 shtete përmes punës së më shumë se 70 ekspertëve të përfshirë në mbledhjen e të dhënave dhe analizave, përdorimit të më shumë se 600 indikatorëve, dhe dhënies së më shumë se 100 rekomandimeve. Në Kosovë, Indeksi për Mbrojtjen e Fëmijës është zbatuar nga Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF.

9

SHTETE

626

INDIKATORË

4

SEKSIONE

MATJA E SISTEMIT TË MBROJTJES SË FËMIJËS TË NJË SHTETI KUNDREJT NJË SETI TË PËRBASHKËT TË INDIKATORËVE

KRAHASIMI MBI SHPENZIMET BUXHETORE PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE

Raporti i Progresit të BE-së për Kosovën në 2016, i rekomandon autoriteteve të Kosovës të “sigurojnë një buxhet adekuat për Projektligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve, në mënyrë që ai të jetë më efektiv, pas miratimit”. Për më tepër, ai thekson se komunat duhet të kenë burime të mjaftueshme në mënyrë që të ofrojnë shërbime sociale. Në këtë mënyrë, “Kosova duhet të bëjë ndryshimet e nevojshme në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal, për të siguruar transferimin e kompetencave për menaxhimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare, tek komunat. Mungesa e qartësisë së komunave në lidhje me buxhetin komunal në dispozicion për ofrimin e shërbimeve sociale, ka rezultuar me ndryshim të nivelit të mbështetjes sa i përket ofrimit të shërbimeve sociale. Prandaj, financimi i veçantë i shërbimeve sociale nga granti i përgjithshëm duhet të jetë i përfshirë në Projektligjin e ardhshëm për Financat e Pushtetit Lokal”.



SHPENZIMET BUXHETORE

Sa i përket shpenzimeve buxhetore për mbrojtje të fëmijëve, Indeksi për Mbrojtjen e Fëmijës tregon se shpenzimet e Kosovës për mbrojtje sociale janë të ulëta në krahasim me shtetet e tjera ku është implementuar Indeksi.

Me këtë alokim financiar të limituar për mbrojtje sociale, rekomandohet fuqishëm që Kosova të rrisë shpenzimet e saj për mbrojtje sociale.

Për këtë arsye, rekomandimet e Indeksit theksojnë se duhen të ndërmerren bisedime të rregullta mes autoriteteve të financave dhe atyre të mbrojtjes sociale. Pa një mekanizëm të krijuar për të shqyrtuar buxhetin dhe shpenzimet në baza vjetore, zyrtarët mund të jenë të kufizuar në mundësitë e tyre për të planifikuar buxhetime të sakta.

Analizat buxhetore për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve duhet të shqyrtojnë përqindjen e buxhetit të përgjithshëm e cila i dedikohet fëmijëve si dhe të identifikojnë çdo pabarazi mes Komunave të Kosovës, dhe grupeve të veçanta të fëmijëve. Është e rëndësishme që zyrtarët të jenë në gjendje të verifikojnë nëse grupeve më të cënuara të fëmijëve u dedikohet një financim i mjaftueshëm.

Indeksi për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Raporti i Progresit të BE-së, përshkruajnë domosdoshmërinë për të hartuar një plan për financim të qëndrueshëm dhe të drejtë të shërbimeve sociale, përmes krijimit të

grantit specifik për shërbime sociale në kuadër të Ligjit të Financave të Pushtetit Lokal. Për më tepër, Indeksi rekomandon fuqishëm hartimin e standardeve financiare për të mbështetur shërbimet dhe për të qenë në linjë me standardet e cilësisë.

Varësia e Kosovës ndaj donatorëve është fakt i njohur edhe nga Raporti i Progresit të BE-së: *“Kosova duhet të marrë pronësinë e plotë sa i përket masave të nevojshme për të mbështetur komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, me synimin për të ulur varësinë ndaj donatorëve”*.

Raporti i Progresit të BE-së rekomandon që Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale duhet të sigurojë financim adekuat për strehimoret që strehojnë fëmijë të cilët janë viktimat e dhunës dhe trafikimit. Në të njëjtën kohë, Indeksi thekson se qeveria financon një gamë shërbimesh për fëmijët në situata të dhunës përmes partneritetit me shoqërinë civile dhe donatorët ndërkombëtarë. Megjithatë, për shkak të vështirësive ekonomike, shteti nuk i financon plotësisht këto shërbime. Si pasojë, këto shërbime gjejnë mbështetje nga donatorët e huaj për të plotësuar këtë zbrazëti. Rekomandohet që shteti të marrë përgjegjësi të mëtijshme për financimin dhe mbështetjen e shoqërisë civile si një hap tjetër drejt përbushjes së detyrimeve të KDF-së.

Krahas standardeve financiare, është e rëndësishme edhe marrja e vendimeve buxhetore si në nivel nacional ashtu dhe atë komunal. Vendimet duhet të jenë në harmoni me problemet në nivel komunal, duke u bazuar në të dhënat e zbërthyer dhe indikatorët duke përfshirë aftësinë e kufizuar dhe faktorët e rrezikut në nivel komunal. Duke qenë se sistemi i shërbimeve dhe i menaxhimit të rasteve në Kosovë është shumë i strukturuar, pamjaftueshmëria e burimeve financiare dhe njerëzore është bërë pengesa kryesore për mbrojtjen e fëmijës.

PRAKTIKA TË MIRA NË RAJON

Sipas Indeksit të Mbrojtjes të Fëmijës, dy vende të tjera të rajonit kanë pasur rezultate më të mira në indikatorët e lidhur me hartimin e standardeve financiare për të mbështetur shërbimet: Rumania dhe Bullgaria. Në Bullgari, çdo vit Ministria e Financave, MLSP, dhe Asociacioni Kombëtar i Komunave në Republikën e Bullgarisë marrin një vendim i cili rregullon standartet financiare për të gjitha shpenzimet që shteti duhet të sigurojë. Standartet financiare janë në dispozicion për të gjitha shërbimet e deleguara nga shteti tek ofruesit e ndryshëm të shërbimeve, sipas Aktit të Ndihmës Sociale (e vitit 1998, e ndryshuar në vitin 2013). Çdo vit financiar, qeveria miraton rregulloren për kriteret dhe standartet financiare për këto shërbime. Shteti delegon aktivitete si bazë për financimin e shërbimeve nga buxheti i shtetit. Standartet bazohen në të hyrat për person dhe numrin e përfituesve.



RUMANIA
BULLGARIA

KRAHASIMI MBI FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Raporti i Progresit të BE-së për Kosovën rekomandon që Kosova të përmirësojë përshtirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor duke rritur numrin e stafit profesional dhe asistentëve personal dhe duke siguruar se fëmijët me aftësi të kufizuara vijojnë mësimin në shkolla publike së bashku me bashkëmoshatarët e tyre. Indeksi për Mbrojtjen e Fëmijës tregon se Kosova ka një rezultat me 0.359 nga totali i mundshëm prej 1.0, në veprimet e saj për të mbrojtur fëmijët me aftësi të kufizuara.

Në renditjen e përgjithshme, Kosova renditet e teta në mesin e nëntë shtetveve të Indeksit. Edhe pse vendi ka rezultate relativisht të larta në ligjet dhe politikat për aftësinë e kufizuar (0,688), rezultatet janë dukshëm më të ulëta në shërbime (0,375), kapacitet (0,100) dhe llogaridhënie (0,167). Ndërkohë që mekanizmat e koordinimit, sikurse ligji dhe politikat, flasin për dispozita të mira ligjore të Kosovës (0,667).

Kuadri ligjor i Kosovës adreson diskrimimin ndaj personave me aftësi të kufizuara, kërkon mjedise gjithëpërfshirëse për arsim dhe shërbime të tjera (duke përfshirë aktivitetet rekreative) dhe përcakton direktivat për qasje adekuate në ndërtesa dhe konstruksione.

Standartet që rregullojnë shërbimet për fëmijët me aftësi të kufizuara, janë të vendosura. Rekomandohet që të krijohen standarte financiare për shërbimet e dedikuara për fëmijët me aftësi të kufizuara. Pa standarde financiare, shërbimet nuk do të mund të mbështeten në mënyrë adekuate.

Ky rekomandim ka të bëjë me rezultatin e dobët të kapacitetit të Kosovës për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe sugjeron rekomandimin në vijim: prioritizimi i mbrojtjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara duke rritur investimet financiare në shëndetësi, mirëqenie sociale dhe arsim, që kanë për qëllim gjithëpërfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Me legjislacion, shkollat janë vende gjithëpërfshirëse, por mësuesit ende nuk kanë trajnime të nevojshme dhe burime për të përfshirë në mënyrë të vazhdueshme fëmijët me aftësi të kufizuara. Rekomandohet që numri i specialistëve të trajnuar dhe të kualifikuar brenda fushës së arsimit të rritet me qëllim të integritimit efektiv të fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor.



FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Një hap tjetër i mirëpritur do të përfshinte përpjekjet për reformimin e mësimdhënies dhe kurrikulave për të promovuar përfshirje më të madhe. Barrierat fizike janë gjithashtu të rëndësishme. Ka shumë institucione publike, duke përfshirë shkolla, gjykata dhe Qendra për Punë Sociale të cilët nuk kanë ashensorët e nevojshëm, pjerrtësinat dhe pajisjet ndihmëse (për shembull, në banjo) që do të lehtësonin përdorimin nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Komunitet, bazuar në mandatin e tyre ligjor, duhet të zhvillojnë shërbime sociale me bazë në komunitet për fëmijët me aftësi të kufizuara. Krijimi i qendrave të kujdesit ditë është nevojë themelore për trajtimin, rehabilitimin dhe reintegrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Këto shërbime publike dhe private, duhet të menaxhohen dhe monitorohen në bazë të standarteve të cilësisë dhe atyre financiare.

Një ndër çështjet shqetësuese që dalin nga indikatorët e Indeksit dhe lidhet me aftësinë e kufizuar, është mungesa e një mekanizmi të pavarur të ankesave. Për pyetjen e indikatorit të bazuar në Nenin 23.1 të KDF: “A siguron shteti një mekanizëm të pavarur të ankesave për situatat e diskriminimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe përfaqësuesve të tyre”, rezultati i Kosovës është 0. Pra, nuk ka mekanizma të ankesave në dispozicion për mbrojtjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

PRAKTIKAT E MIRA NË RAJON

Sipas Indeksit për Mbrojtjen e Fëmijës, tre shtete të tjera në rajon kanë rezultat më të mirë në këtë indikator: Rumania, Moldavia dhe Serbia. Në Rumani, institucioni përgjegjës për pranimin e ankesave rreth kësaj çështjeje, është Këshilli Kombëtar për Luftën kundër Diskriminimit. Në Moldavi, ekziston një linjë telefonike e posaçme kundër diskriminimit e cila është pa pagesë dhe konfidenciale, me të cilën mund të telefonohet nga i gjithë vendi.



KRAHASIMI MBI KOORDINIMIN EFEKTIV NË SISTEMIN E MBROJTJES SË FËMIJËS

Raporti i Progresit të BE-së për Kosovën në 2016 thekson se “Edhe pse Zyrtarët e të Drejtave të Fëmijëve kanë qenë të emëruar në shumicën e komunave, impakti i tyre është i limituar”. Veç kësaj, “Institucioni i Avokatit të Popullit duhet të angazhohet edhe më tej në promovimin e të drejtave të fëmijëve”.

Njëjtë, Indeksi për Mbrojtjen e Fëmijës dëshmon se Kosova ka mandatar një zyrë për të drejtat e njeriut, në kuadër të Avokatit të Popullit, e cila promovon të drejtat e fëmijëve. Megjithatë, ai rekomandon rritjen e burimeve njerëzore dhe financiare për Institucionin e Avokatit të Popullit në mënyrë që të rriten aktivitetet në këtë fushë.

Përndryshe mund të jetë e vështirë të paraqiten rekomandime dhe ankesa drejt trupave të ndryshëm në rastet kur ka akuza për shkeljen e të drejtave të fëmijëve. Në anën tjetër, për të mundësuar marrjen e vendimeve koherente dhe të suksesshme, Kosova ka krijuar disa trupa koordinues. Këta trupa duhet të fuqizohen në mënyrë që të garantojnë edhe edhe më tej që fëmijët janë pjesë e debatit dhe e llogaridhënies.

Edhe Parlamenti duhet të themelojë një trup formal për mbrojtjen e fëmijëve, me një mandat të përcaktuar qartë për të monitoruar mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë dhe për tu përgjigjur ndaj çështjeve specifike që mund të shfaqen.

Indeksi ofron një ilustrim të qartë të mungesës të koordinimit dhe pasojave të mundshme të Kosovës në përkushtimin e saj për të drejtat e fëmijëve. Në një indikator referuar Nenit 33.1 të KDF: “A siguron shteti një organ qëndror koordinues për të gjitha veprimet mes agjensive dhe problemeve të ndryshme, për çështjen e mbrojtjes së fëmijëve nga abuzimi me drogë”, rezultati i Kosovës është 0. Pra, nuk ka trupa koordinues në Kosovë që merren me mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi me drogë.



KOORDINIMI

PRAKTIKAT E MIRA NË RAJON

Bazuar në Indeksin e Mbrojtjes së Fëmijës, gjashtë shtete të tjera në rajon kanë rezultate më të mira në këtë indikator: Shqipëria, Bosnja, Bullgaria, Gjeorgjia, Moldavia dhe Rumania. Në Shqipëri, në vitin 2010, Ministria e Punëve të Brendshme ka udhëhequr procesin i cili ka pasur si synim për të rregulluar edhe më tej mekanizmin koordinues të shtetit në fushën e drogës dhe çështje të ngjashme. Në vitin 2011, vendimi për të krijuar një Komitet Ndërministror për Luftën kundër Drogës, mbështetur nga një sekretariat dhe nga Qendra Kombëtare e Informacionit për Drogë, nën kujdesin e Institutit të Shëndetit, është pranuar nga Këshilli i Ministrave. Funkzioni kryesor i Komitetit Ndërministror për Luftën kundër Drogës është të sigurojë koordinimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet sektorëve të ndryshëm të përfshirë në fushën e kontrollimit të drogës. Në Rumani, Agjensia Kombëtare kundër Drogës merret me mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi me drogë, ndërkohë që në Moldavi, Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e Fëmijës konsiderohet si një trup qëndror koordinues për mbrojtje sociale të të gjithë fëmijëve, duke përfshirë përdoruesit e drogës.



KRAHASIMI MBI DREJTËSINË PËR TË MITUR

Raporti i Progresit të BE-së për Kosovën thekson “Për sa i përket qasjes të fëmijëve në drejtësi, është arritur progres i vogël në zhvillimin ligjor dhe të kapaciteteve për zbatimin e duhur të procedurës miqësore për fëmijët në rastet civile dhe administrative. Progres i mirë është arritur përmes protokollit të referimit për të siguruar falas shërbime ligjore dhe profesionale për fëmijët viktime dhe dëshmitarë. Përderisa dispozitat momentale në Kodin e Drejtësisë për të Mitur nuk janë në përputhje me Komitetin e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës në lidhje me periudhën e paraburgimit (12 muaj në vend të 6), në praktikë në dy vitet e fundit asnjë i ri nuk ka qenë i arrestuar për më shumë se 6 muaj.”

Indeksi për Mbrojtje të Fëmijës thekson se në situata të drejtësisë penale, ligji e kufizon ndalimin si aktin “mjetin e fundit” dhe përcakton kohën e mbajtjes së dënimit në proporcion me peshën e veprës. Për shkak se ndalimi mund të kthehet në një formë të dhunës, është e rëndësishme që Kosova të shkojë edhe më tutje në rastet e fëmijëve; korniza ligjore duhet të rishikohet për të përfshirë rekomandimet e Komitetit të KB për të Drejtat e Fëmijës që periudha e paraburgimit të shkurtohet në maksimum gjashtë muaj në rastin e fëmijëve.

Indeksi gjithashtu tregon se ka një numër të kufizuar të gjyqtarëve të specializuar në të drejtat e fëmijëve (3.31 gjyqtarë të specializuar për 100.000 njerëz) në Kosovë. Pa gjyqtarë të specializuar, ka më pak mundësi që procedurat gjyqësore dhe rezultatet të jenë në linjë me KDF.



**DREJTËSIA
PËR TË MITUR**

KRAHASIMI NË MJEDISIN QEVERISËS PËR MBROJTJEN E FËMIJËS DHE NË TË DHËNAT & MONITORIMIN & DHE MEKANIZMAT RAPORTUES

Raporti i Progresit të BE-së 2016 për Kosovën thekson se megjithëse në fushën e të drejtave të fëmijës korniza ligjore në Kosovë është në përputhje me kërkesat ndërkombëtare, zbatimi i saj ende mbetet sfidë. Poashtu ai thekson se në sistemin e mbrojtjes së fëmijës në Kosovë mungojnë mekanizma monitorues dhe të të dhënave: *“Komunat nuk kanë të dhëna të sakta mbi numrin e popullsisë të ndara në gjini, grupmoshë, përkatësi etnike, aftësi apo dobësi, e cila ka një ndikim negativ në planifikimin dhe implementimin e aktiviteteve”*. Kështu, Raporti i Progresit rekomandon që: *“Të dhënat dhe mekanizmat e monitorimit për të vlerësuar përparimin në zbatimin e të drejtave të fëmijëve duhet të përmirësohen”*. Sipas Indeksit për Mbrojtjen e Fëmijës, Kosova renditet e gjashta nga gjithsej nëntë shtetet, në kategorinë e *“mjedisit të qeverisjes”*.

Kosova zë vendin e gjashtë në mesin e nëntë shteteve të Indeksit në kategorinë *“qeverisja”*. Ajo ka arritur një rezultat prej 0,525 nga totali 1,0, krahasuar me Rumaninë e cila renditet e para me 0,742. Rezultati reflekton konsolidimin e kufizuar të ligjeve të cilat i mbrojnë fëmijët në Kosovë dhe gjithashtu edhe dobësinë e trupave formale të cilat monitorojnë dhe mbajnë të përgjegjshëm akterët që kanë për detyrë të mbrojnë fëmijët. Legjislacioni i ri i Kosovës për të drejtat e fëmijëve duhet të konsolidojë mbi 14 ligje të cilat rregullojnë çështjet për mbrojtjen e fëmijëve. Për t'i zbatuar këto ligje, Kosova i obligon të gjithë zyrtarët shtetëror dhe profesionistët që kanë për detyrë të kujdesen për fëmijët në sektorët e shëndetësisë, arsimit dhe drejtësisë të raportojnë dyshimet për dhunë në Qendrën për Punë Sociale respektive ose tek autoritetet policore të Kosovës. Përkundër kësaj përpjekjeje, referimet prej këtyre institucioneve mbeten në shkallë të ulët, sidomos në rastet e dhunës në shkolla. Rekomandohet që Kosova të fillojë me trajnime dhe fushata vetëdijësimi për t'i përkujtuar zyrtarëve shtetëror dhe profesionistëve detyrën e tyre për të raportuar situata të dhunës së ushtruar ndaj fëmijëve. Kosova gjithashtu ka krijuar mekanizma raportues për fëmijët. Një linjë telefonike për ofrim të ndihmës mundëson raportimin e bashkëmoshatarëve dhe shërben që fëmijët të vetë-raportojnë përmes zyrës së Mbrojtësit të Viktimave.



QEVERISJA



TË DHËNA
MONITORIM
RAPORTIM


Qendrat për Punë Sociale (QPS) të vendosura në të gjitha komunat gjithashtu kanë kuti të ankesave, por siç është rasti me linjat telefonike këto kuti janë të hapura për të gjithë qytetarët, jo posaçërisht për fëmijët, dhe janë të vendosura më shumë në qendra se në mjediset shkollore. Kështu, është e nevojshme për tu siguruar fëmijëve më shumë mjedise miqësore për vetë-raportim. Rezultatet e Indeksit rekomandojnë që kjo linjë kombëtare të jetë pa pagesë dhe e qasshme për të gjithë fëmijët.

Linja e re duhet të operojë me ndihmën e ekspertëve të cilët janë në gjendje ta mbështesin, këshillojnë dhe ti shërbejnë këtij grupi në rrezik, dhe në të njëjtën kohë ajo duhet të promovohet përmes fushatave të vetëdijëimit të drejtuara në mënyrë specifike për fëmijët.

Llogaridhënia për vendimmarrje dhe shërbime për të gjitha kategoritë e fëmijëve në nevojë për mbrojtje mbeten të kufizuara. Njësia e re e monitorimit dhe vlerësimit në Kosovë në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale përfaqëson një hap të fuqishëm drejt krijimit të mekanizmave llogaridhënës për kontroll të cilësisë. Megjithatë, ky nuk është organ i pavarur i cili qëndron autonom ndaj akterëve politik dhe nxitjeve politike. Rekomandohet që Kosova të krijojë një organ të pavarur inspektimi për të monitoruar cilësinë e ofrimit të shërbimeve.

PRAKTIKAT E MIRA NË RAJON

Sipas Indeksit të Mbrojtjes së Fëmijëve, katër vende të tjera në rajon kanë pasur rezultate më të mira në treguesit që lidhen me linjat telefonike: Bullgaria, Moldavia, Rumania and Serbia. Në Bullgari për shembull, ka një linjë telefonike themeluar që nga viti 2009, nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e Fëmijës. Për më tepër, që në vitin 2014 funksionon një sistem kombëtar për dorëzimin e hershëm të sinjaleve për fëmijët e rrëmbyer dhe të zhdukur, e lidhur me linjën emergjente kombëtare 112. Në Rumani është linja Kombëtare për Ndihmë të Fëmijës 116111. Shumica e zyrave të DGASPC (Drejtoria e Përgjithshme për Asistencë Sociale dhe Mbrojtje të Fëmijës) në Rumani, kanë zhvilluar linja të drejtëpërdrejta për fëmijët (88.64%). Numri emergjent 112 është poashtu i lidhur me linjën e ndihmës për fëmijë. Në Serbi është linja SOS, e destinuar për fëmijë dhe pjesërisht e financuar nga Ministria e Punës, Punësimit dhe Politikave Sociale. Linja pranon raporte në forma të ndryshme të dhunës ndaj fëmijëve, dhe ofron këshillim psikologjik. Një linjë telefonike e ngjashme ka funksionuar në Moldavi që nga viti 2013, me financim të qeverisë.




BULLGARIA
MOLDAVIA
RUMANIA
SERBIA

PËRFUNDIME

Kosova duhet të bëjë ende shumë përpjekje për të mundur një koordinim më efektiv brenda sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, në dhënien e kujdesit më të mirë për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe në mbledhjen e të dhënave relevante dhe monitorimin e parametrave të sistemit për mbrojtje të fëmijës. Ajo duhet ta bëjë këtë në përputhje me angazhimet e saj ndërkombëtare, duke përfshirë Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës, dhe në kuadër të procesit të saj të integritimit me Bashkimin Evropian.

- Hartimi i standarteve financiare për të financuar në mënyrë të duhur shërbimet dhe për ti vënë në linjë me standartet e cilësisë. Pa standarte financiare të përcaktuara, është vështirë të sigurohet buxheti i qëndrueshëm dhe i mjaftueshëm për shërbime. Financimi jo i sigurtë dhe i pamjaftueshëm ka një ndikim të përgjithshëm negativ në strukturën / cilësinë e stafit dhe disponueshmërinë e pajisjeve. Kjo si pasojë, ul cilësinë e shërbimeve të ofruara.
- Krijimi i mekanizmave të qëndrueshëm, të pavarur për monitorim dhe inspektim për kontrollin e cilësisë së ofrimit të shërbimit dhe për administrimin e licensimit. Inspektimi duhet të kontrollojë shërbimet private dhe publike (QPS-të). Do të jetë e domosdoshme të shtohet licensimi i detyrueshëm, që lidhet me standartet e cilësisë dhe financimit, për të gjithë ofruesit e shërbimit. Inspektimi është i domosdoshëm për të siguruar cilësinë dhe kompetencat për të gjithë ofruesit e shërbimeve. Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare siguron inspektimin e shërbimeve mirëpo inspektimi ende nuk është kthyer në praktikë. Inspektimet duhet të rregullohen sipas vitit dhe shërbimit.
- Krijimi i një organi të përhershëm parlamentar, të mandatuar për të monitoruar çështjet e mbrojtjes së fëmijëve, në mënyrë që të realizohet një kontroll shtesë për autoritetet e sektorit publik dhe të shërbejë si një zë i qytetarëve.
- Krijimi i një linje të re telefonike pa pagesë, të dizajnuar me dhe për fëmijët. Shërbimi duhet të pranojë telefonatat dhe të ofrojë mbështetje, këshillim dhe krijim të rrjetit për fëmijët në situata të dhunës, abuzimit, neglizhimit, abuzimit me substanca narkotike,



REKOMANDIME

rrëmbimit, trafikimit dhe formave të tjera të shfrytëzimit.

- Zhvillimi i mëtejshëm i standardeve të cilësisë mund të kërkohet për shërbimet e specializuara të këshillimit, linjat telefonike për ndihmë dhe shërbimet e ndërhyrjes emergjente. Hulumtimet dhe grumbullimi i të dhënave duhet të prioritetizohet për të përcaktuar dominimin e çështjeve të ndryshme në Kosovë. Këto të dhëna duhet të përfshijnë numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, fëmijët e angazhuar në punë të rrezikshme, fëmijët viktime të dhunës, fëmijët që abuzojnë me substanca narkotike etj. Të dhënat e tilla duhet të ndahen në detaje sipas moshës, gjinisë, kategorisë dhe komunës.
- Specifike për fëmijët me aftësi të kufizuara, është krijimi i qasjes së përshtatshme dhe i mjediseve gjithëpërfshirëse për shërbimet e rehabilitimit, arsimit, kujdesit shëndetësor dhe rekreacionit.
- Është i domosdoshëm krijimi i planit për financim të qëndrueshëm dhe të drejtë të shërbimeve sociale në tërë Kosovën, përmes krijimit të grantit specifik për shërbime sociale në kuadër të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal.

BURIMET

Kosovo 2016 – Measuring government efforts to protect girls and boys by Jocelyn Penner Hall & Andy Guth : <http://www.childprotectionindex.org/country/kosovo>

The 2016 EU Progress Report on Kosovo https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_kosovo.pdf

Për informata më të hollësishme se si Kosova mund të përmirësojë sistemin e saj të mbrojtjes së fëmijëve, lexoni përmbledhjen e rezultateve të Indeksit për Mbrojtjen e Fëmijës dhe rekomandimet për Kosovën, këtu.

Lexoni më shumë rreth Indeksit për Mbrojtjen e Fëmijës në: www.childprotectionindex.org





FALENDERIME

Hartuar & Edituar: Roxana Todea &
Cristina Negoiescu
Dizajni: Elena Herlea
Fotografia: Roxana Todea

KONTAKTET

CHILDPACT
www.childpact.org
E: info@childpact.org
FB: @childpact

KOMF
www.komfkosova.org
E: info@komfkosova.org
FB: @komf_kosova